



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 71, datë 20.02.2024

**PËR
MIRATIMIN E “RAPORTIT VJETOR MBI VEPRIMTARINË E KËSHILLTARIT
PËR ETIKËN PËR VITIN 2023”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenit 83 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Raportit vjetor mbi veprimtarinë e Këshilltarit për Etikën për vitin 2023” sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Nr. Prot.

Tiranë, datë 02.02.2024

Lënda: Raportim mbi veprimtarinë e Këshilltarit për Etikën gjatë vitit 2023

KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

E nderuar znj. Kryetare,
Të nderuar Anëtarë,

Në përmbushje të detyrimit tim si Këshilltare për Etikën, në zbatim të nenit 83, pika ‘4’, shkronja ‘d’ të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (në vijim ligji 115/2016), po Ju përcjell një raportim të përmbledhur, lidhur me veprimtarinë time gjatë vitit 2023. Në vijim të raportimit për punën e zhvilluar në vitet e mëparshme, ritheksoj faktin se komunikimi me gjyqtarët vijon të jetë jo në nivelin e pritur, ndonëse gjatë vitit 2023 ka pasur disa reagime kryesisht të lidhura me përdorimin e rrjeteve sociale dhe postimet në internet, si dhe kanë kërkuar mendime për dilema të caktuara që gjyqtarët kanë pasur për pjesëmarrje në veprimtari jashtë funksionit.

Me miratimin e Kodit të Etikës Gjyqësore, për mua si Këshilltare e Etikës filloi puna për evidentimin e dilemave etike, prandaj komunikimi me gjyqtarët është i rëndësishëm, për të qenë sa më praktike dhe konkrete, në lidhje me interpretimin e parimeve të etikës. Në kushtet kur komunikimi me gjyqtarët ka qenë në nivele minimale (ndonëse këtë vit është rritur ky komunikim në raport me vitet e tjera), vijnë vështirësitë në identifikimin e rasteve apo problematikave që lidhen me çdo parim etike të parashikuara në Kod, vështirësi që lidhet më së shumti me shmangien e trajtimeve teorike. Gjatë vitit 2023, kam konstatuar disa reagime në lidhje me postime të caktuara në internet/rrjetet sociale, ku në disa raste është sugjeruar mes gjyqtarëve (njëri -tjetrit) opinioni i Këshilltares për Etikën në lidhje me këtë fakt. Kjo tregon sa e rëndësishme është që dilemat etike të jenë konkrete dhe të lidhen me situata të caktuara.

Gjatë vitit 2023 komunikimi me gjyqtarët ka qenë i lidhur kryesisht me përdorimin e rrjeteve sociale dhe postime të ndryshme, si dhe në një rast gjyqtari ka kërkuar mendim në lidhje me pjesëmarrjen në një emision televiziv, ku do të trajtoheshin çështje të caktuara të lidhura me drejtësinë penale. Rastet e parashtruara kanë qenë të tilla që në vlerësimin tim, nuk kanë diktuar nevojën e dhënies së një opinioni të përgjithshëm për të gjithë gjyqtarët, por do të përfshihen në manual si pjesë e dilemave etike, natyrisht pa cenuar konfidencialitetin.

Gjithsesi, duke u rikthyer tek përdorimi i rrjeteve sociale, ritheksoj edhe një herë sugjerimin e parashtruar edhe në raportimin e vitit të kaluar, për nevojën e ndërhyrjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) nëpërmjet nxjerrjes së një udhëzimi të përgjithshëm në lidhje me këtë temë, që është një praktikë e njohur edhe në vende të tjera.

Në analizë të shkaqeve për të cilat ky komunikim i gjyqtarëve me Këshilltaren e Etikës nuk është në nivelet e pritshme, mendoj se vijon të jetë ngarkesa në ushtrimin e funksionit, si dhe fillimi i zbatimit të hartës së re gjyqësore. Një shkak tjetër është edhe mungesa e informacionit, ndonëse i janë dërguar përmes postës elektronike të dhënat e mia si Këshilltare e Etikës, si dhe opinionet e publikuara edhe në faqen web të KLGJ. Pavarësisht këtij fakti, në disa raste gjyqtarët pohojnë se nuk kanë qenë të sigurtë ku të adresonin problematikën e tyre apo dilemën që kishin në lidhje me sjellje të caktuara etike. Një shkak tjetër mund të jetë edhe ngurrimi i gjyqtarëve për të diskutuar elemente që lidhen me shkelje të etikës, si pasojë mbase edhe faktit që Këshilltari i Etikës zgjidhet nga KLGJ. Përfitoj nga rasti që të ritheksoj se çdo komunikim është konfidencial dhe tërësisht i shkëputur nga veprimtaria e KLGJ apo nga çdo lloj iniciative disiplinore. Opinionet e Këshilltarit të Etikës për çështje apo dilema të caktuara që gjyqtarët mund të kenë si gjatë ushtrimit të funksionit ashtu edhe për verpimtari jashtë funksionit, duhen vlerësuar thjesht si këshilla që vijnë në ndihmë të tyre për të shmangur sjellje apo veprime që mund të vënë në dyshim pavarësinë, paanësinë apo integritetin e gjyqtarit.

Gjatë vitit 2023, një element shumë i rëndësishëm që ka ndikuar pozitivisht në punën time si Këshilltare e Etikës ka qenë bashkëpunimi me projektin e BE “Përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve të pavaruara të drejtësisë në Shqipëri”/EU4Justice, ku një nga institucionet që mbështet ky projekt është edhe KLGJ. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, kemi ndërmarrë disa hapa konkretë në evidentimin e dilemave etike, mes të cilave me shumë rëndësi ishte edhe zhvillimi i një trajnimit me mbështetjen edhe të Shkollës së Magjistraturës. Ky trajnim kishte një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse, jo vetëm gjyqtarë por edhe prokurorë e inspektorë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Diskutimet dhe dilemat e parashtruara si dhe ballafaqimi me eksperiencën spanjolle nga dy gjyqtarë të Gjykatës së Lartë në Spanjë, njëkohësisht edhe anëtarë të Komisionit të Etikës atje, ishin me shumë interes. Ky trajnim është një hap pozitiv dhe vetëm fillimi i një bashkëpunimi, që do ndikojë në përditësimin e dilemave etike dhe një përmirësim të trajtimit të tyre nga ana ime deri më tani, me qëllim finalizimin dhe publikimin e tyre brenda këtij viti.

Një rol të rëndësishëm në veprimtarinë e Këshilltarit të Etikës ka edhe bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës, ku janë bërë përpjekje për të përfshirë disa tema që lidhen me Kodin e Etikës Gjyqësore në programin e trajnimit vazhduar, i cili duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe sa më afër praktikës gjyqësore. Në kuadër të bashkëpunimit me projektin EU4Justice, Shkolla e Magjistraturës ka ofruar mbështetjen maksimale dhe ka kërkuar që ky trajnim të përsëritet, me qëllim që të trajnohen sa më shumë gjyqtarë e prokurorë, ku në fokus do të jenë magjistratët e emëruar vitet e fundit. Në këtë drejtim, falenderoj KLGJ dhe znj.

Irena Plaku në veçanti, që lehtësoi komunikimin me përfaqësuesit e këtij projekti, duke luajtur një rol aktiv edhe në zhvillimin e këtij trajnimi.

Në vijim, Ju riinformoj edhe një herë se puna për hartimin e manualit, sipas parashikimit të nenit 83, pika '4', shkronja 'c' të ligjit nr. 115/2016 është duke vijuar. Gjatë raportimeve për vitin 2021 dhe 2022 kam vënë theksin tek domosdoshmëria për të pasur një mbështetje me burime njerëzore, në zbatim të pikës 7 të nenit 83 të ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë", me qëllim që puna e nisur të përfundojë brenda një afati të arsyeshëm, si dhe për të mundësuar dhe për të rritur efektivitetin në veprimtarinë time si Këshilltare për Etikën. Në fakt, që nga muaji tetor 2023 kjo mbështetje më është ofruar përmes projektit EU4Justice, që shpresoj të mos mbetet vetëm në kuadër të trajnimit të zhvilluar në datat 31 janar, 1 e 2 shkurt 2024, por të vijojë edhe gjatë hartimit e përditësimit të manualit informues mbi dilemat etike. Ju bëj me dije se një draft i parë i këtij manuali është përgatitur nga ana ime, por nuk është finalizuar pasi ky trajnim dhe komunikimi me gjyqtarët është me rëndësi, për të qenë konkrete dhe sa më shteruese, po jo e ngurtë në dhënien e opinionëve. Më lejoni të tërheq edhe një herë vëmendjen Tuaj se, në funksion të përgatitjes të një manuali informues sa më të plotë dhe shterues (duke pasur në konsideratë faktin se dilemat etike shpesh janë të komplikuara dhe sfiduese), është e domosdoshme mbështetja me burime njerëzore

Duke shpresuar në mbështetjen edhe vijimin e bashkëpunimit me Ju,

KËSHILLTARE PËR ETIKËN
ALBANA BOKSI